



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P.479/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.07.2019, shqyrtoi ankesen me:

Objekt: Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr.1202 prot, datë 04.07.2019 për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me nr. REF-24669-05-30-2019 me objekt Loti I “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i rrugëve të bllokut që kufizohet nga rrugët “Leandro Zoto”- “Maria Kraja”- “Disha” – “Sadik Petrela” me fond limit 1,770,062 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 10.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Ankimues: “Instituti Dekliada Alb” shpk
Rruga “Milto Tutulani”, ndërtesa 4, hyrja.10, apartamenti.6 Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia e Tiranës
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”

Baza Ligjore: Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë

12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 31.05.2019 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me nr. REF-24669-05-30-2019 me objekt Loti I “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i rrugëve të bllokut që kufizohet nga rrugët “Leandro Zoto”- “Maria Kraja”- “Disha” – “Sadik Petrela” me fond limit 1,770,062 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 10.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 10.06.2019 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 11.06.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.4. Në datën 18.06.2019 ankimuesi ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.5. Me shkresën nr. 24963/2 prot datë 25.06.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues ku ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.6. Në datën 04.07.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr.27715/1 prot datë 15.07.2019 protokolluar me tonën me nr.1202/2 prot datë 16.07.2019 me objekt “*Dërgohet informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Në datën 18.07.2019, operatori ekonomik “Instituti Dekliada-Alb” shpk ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me nr. REF-24669-05-30-2019 me objekt Loti I “*Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i rrugëve të bllokut që kufizohet nga rrugët “Leandro Zoto”- “Maria Kraja”- “Disha” – “Sadik Petrela” me fond limit 1,770,062 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 10.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.*

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik “Instituti Dekliada-Alb” shpk për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me nr. REF-24669-05-30-2019 me objekt Loti I “*Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i rrugëve të bllokut që kufizohet nga rrugët “Leandro Zoto”- “Maria Kraja”- “Disha” – “Sadik Petrela” me fond limit 1,770,062 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 10.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik i drejtohet ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i cili, në nenin 94 “*Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës*”, pika 1, parashikon se: “*Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë*”.

III.1.2. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në objekt ankimimin e tij, dhe si pasojë mos shqyrtimit të ankesës së tij nga KPP lidhur me këto pretendime. Heqja dorë

nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimes sjell si rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

Për sa mësipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me nr. REF-24669-05-30-2019 me objekt Loti I “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i rrugëve të bllokut që kufizohet nga rrugët “Leandro Zoto”- “Maria Kraja”- “Disha” – “Sadik Petrela” me fond limit 1,770,062 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 10.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1202 Protokoli; Datë 04.07.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

